



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 19, datë 18.01.2023

PËR

**HAPJEN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E RRETHIT
GJYQËSOR TIRANË, PËR NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS
CIVILE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur më datë 18.01.2023, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “ç” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Kreun IV, Seksioni A, pikat 7-11, të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës së lëvizjes paralele dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për lëvizjen paralele në detyrë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

II. Afati i kandidimit

3. Afati i kandidimit është deri më datë 01.02.2023.

III. Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit

4. Në procedurën e lëvizjes paralele sipas këtij vendimi mund të konkurrojë çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë, në një pozicion të komanduar ose në skemë delegimi, i cili plotëson kriteret ligjore për lëvizjen paralele në pozicionin e lirë për të cilin është hapur procedura.
5. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për lëvizjen paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përcaktohen në nenin 8, pika 3, në nenin 43, pika 2, shkronja “a”, “c” dhe pika 6, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:
 - a) Kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit;
 - b) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi;
 - c) Kandidati nuk duhet të jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale.
6. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - dh) fotokopje të vlerësimeve etike dhe profesionale, në rast se ka.
7. Dokumentacioni sipas pikës 6, të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

IV. Procedura e lëvizjes paralele

8. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

- a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve ligjorë të kandidimit;
 - b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;
 - c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.
9. Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.
10. Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjorë të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij vendimi, proces ky që realizohet sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”.
11. Në rast se për pozicionin e lirë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie tërhiqen nga kandidimi, ose kur ata nuk kualifikohen për mosplotësim të kriterëve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional.
12. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk do të mund të vazhdojë edhe për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo do të vazhdojë për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional.
13. Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar me vendim përfundimtar, në fazën e dytë të procedurës së lëvizjes paralele zbatohen rregullat sipas Kreut VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, përveç sa parashikohet ndryshe në “Dispozitat për periudhën kalimtare” sipas Kreut VIII të tij.
14. Për kandidatin e kualifikuar me vendim përfundimtar, me përjashtim të atij që përpara kandidimit ka qenë në një pozicion të komanduar në vitin e fundit kalendarik, fillon procesi i vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullave të

parashikuara në nenin 22, Kreu V, të Vendimit të Këshillit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”.

15. Për kandidatin që është në një pozicion të komanduar prej jo më pak se viti i fundit kalendarik nga momenti i kandidimit, si vlerësim etik dhe profesional konsiderohet ai i bërë nga institucioni ku kandidati është i komanduar. Në rast të mospasjes së një vlerësimi të tillë, mbi kërkesën e kandidatit, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional sipas nenit 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

16. Në fazën e tretë të procedurës së lëvizjes paralele, kandidati i renditur më lart transferohet në pozicionin e lirë me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VETËDEKLARIM
PËR MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës _____, të shpallur me Vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 6, të nenit 43, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi.

Lëshuar më ____ . ____ . ____

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)
(*Nënshkrimi*)

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës _____, të shpallur me Vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 8, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më ____ . ____ . ____

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)
(*Nënshkrimi*)